


Nenad Perosheviq
Millosh Vukanoviq

Nuk e di të kujt janë këta aeroplanë, por bombat janë tonat

Bombardimi i Jugosllavisë nga aleatët
gjatë Luftës së Dytë Botërore





Pyetja kyçe Kush pi, e kush paguan?



Tema

Tema ka të bëjë me periudhën e bombardimeve të aleatëve në qytetet e Jugosllavisë gjatë periudhës 1943-1944; Ngjashëm me pjesën tjetër të Evropës, kjo temë kryesisht është lënë pas dore në tekstet mësimore të historisë, edhe pse ka shkaktuar me mijëra viktima dhe shkatërrim të shumë qyteteve. Bombardimet kanë ndodhur anekënd ish republikave të Jugosllavisë dhe deri në ditët e sotme mbetet temë kontroverse si për shkak të arsyes dhe shkallës së bombardimeve, ashtu edhe për atë se kush e urdhëroi bombardimin.



Qëllimet:

Qëllimi i punëtorisë është që nxënësve t'ua ofrojë temën e shkatërrimit dhe vuajtjeve të popullsisë civile të shkaktuar nga bombardimet masive ajrore. Punësoria është fokusuar në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, më saktësisht në bombardimet e aleatëve të qyteteve të Jugosllavisë. Edhe pse bombardimet nga ana e Fuqive të Boshtit janë paraqitur në punëtori, fokusi kryesor është në aktivitetet e aleatëve, pikërisht për shkak të shkallës së shkatërrimit që është shkaktuar. Qasja kritike në këtë temë do ta ngre diskutimin për miqësinë e singërtë dhe interesin në marrëdhëniet ndërkombëtare atëherë në periudhën e luftës.



Rezultatet e mësimi

- Nxënësit do t'i analizojnë burimet historike.
- Nxënësit do të zhvillojnë vetëdije për tmerret e luftës dhe jetën nën bomba.
- Nxënësit do të njihen raportin e politikës bashkëkohore ndaj ngjarjeve historike.

Udhëzimet për mësimdhënësin

Mësimdhënësi e fillon punëtorinë me stuhi idesh:

1. Cilat caqe bombardohen dhe cili është dallimi mes caqeve ushtarake dhe civile?
2. Si mendoni sa ishin precize bombardimet gjatë Luftës së Dytë Botërore?
3. Për cilin bombardim të kohëve të fundit jeni në dijeni?
4. A e din nëse ndonjëherë është bombarduar qyteti yt?



45
minuta

Mësimdhënësi vazhdon me hyrjen. Nxënësit e lexojnë tekstin hyrës, burimin 1 dhe e analizojnë hartën. Mësimdhënësi nxënësve ua parashtrohet pyetjet në fund të hyrjes. Pasi që nxënësit u përgjigjen pyetjeve, mësimdhënësi e vizaton shiritin e kohës dhe kërkon nga nxënësit që në të t'i shkruajnë datat më të rëndësishme të tekstit hyrës.

Aktiviteti 1

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në 4 grupe dhe secilit grup i jep burime nga qytetet të caktuara; Leskovac, Podgoricë, Beograd dhe Zarë.

Secili grup e ka detyrën e njëjtë, që me shfrytëzimin e tekstit dhe fotografisë të shkruajë raport gazetaresk nga këndvështrimi i gazetarëve të ndryshme.

Grupi 1 (Leskovac) – Shkrimi i raportit gazetaresk nga këndvështrimi i gazetarit sovjetik.

Grupi 2 (Podgoricë) – Shkrimi i raportit gazetaresk nga këndvështrimi i gazetarit britanik.

Grupi 3 (Beograd) – Shkrimi i raportit gazetaresk nga këndvështrimi i gazetarit gjerman.

Grupi 4 (Zarë) – Shkrimi i raportit gazetaresk nga këndvështrimi i gazetarit jugosllav (partizan).

Përfaqësuesit e secilit grup i lexojnë raporte gazetareske.

Pas leximit të raporteve gazetareske ligjëruesi i pyet nxënësit që t'i krahasojnë dhe diskutojnë raportet e grupeve të tjera.

Aktiviteti 2

Në fund, mësimdhënësi e prezanton burimin 5 dhe fotografitë e dy përmendoreve. Kërkon nga nxënësit ta shohin materialin, të përgjigjen në pyetjet dhe ta thonë mendimin e tyre.

HYRJE

Bombardimin e parë të Jugosllavisë gjatë Luftës së Dytë Botërore e kreu aviacioni i Gjermanisë fashiste më 6 prill të vitit 1941. Kryerja e detyrës iu ngarkua flotës së tretë ajrore. Qëllimi kryesor i bombardimit ishte Beogradi, mirëpo krahas tij u sulmuan edhe Novi Sadi, Sarajeva, Nishi, Mostari, Banja Lluke, ndërkaq aviacioni italian sulmonte bregdetin kroat, Podgoricën dhe qytetet tjera. Operacioni i bombardimit të Beogradit mbante emrin sekret “Gjykimi Final”.

Krahas faktit që Qeveria Jugosllave dhe Komanda Supreme e Beogradit e shpallën Beogradin “qytet të hapur”, 484 avionë në mënyrë intensive e bombarduan qytetin më 6 dhe 7 prill 1941.

Gjatë bombardimit të Beogradit u vranë 2.274 njerëz. U rrënuan 627 ndërtesa, ndërsa më shumë se 10.000 u dëmtuan rëndë ose pjesërisht, duke përfshirë edhe një pjesë të Oborrit të Vjetër. Ndërkaq monumenti më i rëndësishëm i kulturës i rrënuar gjatë bombardimit është Biblioteka Kombëtare me 300.000 libra, përfshirë këtu edhe dokumentet mesjetare me vlerë të paçmueshme. Sipas burimeve gjermane, mënyra e vjetër e ndërtimit të shtëpive dhe organizimi jo i mirë zjarfikës dhe i mbrojtjes civile sollën vdekjen e numrit të madh të njerëzve.

Aleatët perëndimorë e rritën interesimin për luftimet në Jugosllavi krahas zgjerimit të operacioneve të luftës drejt jugut të Evropës. Aviacioni i aleatëve përkohësisht veproi në territor të Jugosllavisë së okupuar nga prilli i vitit 1943. Nata e parë e bombardimit ishte më 20 prill 1943, me sulmin mbi Shkupin dhe Nishin.

Sulmet e aviacionit aleat u bënë më intensive gjatë gjysmës së dytë të vitit 1943, kur u njoh Ushtria Nacionalçlirimtare e Jugosllavisë (partizanët). Pranimi formal i UNÇJ-së në Konferencën e Teheranit ndikoi në zhvillimin e lidhjeve të saja luftarake me aleatët gjatë gjysmës së parë të vitit 1944. Vendimi për të ndihmuar Ushtrinë Nacionalçlirimtare në të njëjtën kohë nënkuptonte përfshirjen e këtyre forcave në planet më të gjera të aleatëve në luftën kundër trupave gjermane. Sulmet intensive ajrore të aleatëve ishin të ndikuara për faktin që Ballkani mori rëndësi të veçantë për gjermanët në vjeshtë të vitit 1943 dhe sidomos nga pranvera e vitit 1944, për arsye të thyerjes së frontit gjerman në Itali në prill të vitit 1944 dhe operacionit ‘Overlord’ në qershor të vitit 1944. Përpjekjet e aleatëve ishin që përmes bombardimit të pengonin tërheqjen e forcave gjermane nga Greqia, Shqipëria dhe Maqedonia.

Kërkesa e parë për të bombarduar Beogradin u dërgua nga gjenerali Drazha Mihailloviq kryetarit të qeverisë jugosllave në emigrim Slobodan Jovanović (përmes ambasadorit britanik në qeverinë jugosllave Rendel) më 4 nëntor 1942.

Komandanti suprem i Ushtrisë Nacionalçlirimtare Josip Broz Tito, më 17 maj të vitit 1943 (në fillim të ofensivës së 5-të të armikut) në letrën dërguar Shtabit Kryesor të njësiteve të tij në Kroaci, e arsyetoi pranimin e bashkëpunimit me aleatët dhe i informoi rreth kërkesës për të bombarduar Beranën, Bjelo Poljen, Plevlen, Andrijevicën, Mostarin, Podgoricën dhe Nikshiçin.

* UNÇJ – Ushtria Nacionalçlirimtare e Jugosllavisë – partizanët



Burimi 1

Qytetarët e befasuar të Nikshiqit fshiheshin nëpër shtëpi e bodrume pas sulmit të parë të avionëve. Mirëpo, shumë prej tyre, për të mos mbetur nën gërmadha, rrinin nëpër vende të hapura. Në sheshin te çezma pranë shtëpisë së Katuriqëve, Stevan Zlatni Vuković, në “qetësi” shikonte qiellin dhe fliste me vete. Lidhur me këtë kujtohet një anekdotë. Në pyetjen e një qytetari, i cili gjithashtu nuk donte të fshihej në shtëpi: “Të kujt janë avionët”, ai serioz i është përgjigjur: “Nuk e di të kujt janë avionët, por bombat i di se janë tonat”.

Maksim Vujačić, Trg Slobode (1885-2007), Nikšić, 2007. str. 48-49

Pyetje

1. Kur dhe pse aleatët e filluan fushatën për bombardimin e Jugosllavisë?
2. Çka dëshironte të thotë qytetari i përmendur i Nikshiqit me përgjigjen e tij?
3. A praktikoheshin bombardimet ajrore vetëm gjatë Luftës së Dytë Botërore?
4. A din ndonjë shembull tjetër të bombardimit ajror?

Burimi 2

Fotografitë e bombardimeve në Leskovac, Serbi

Bullgarët e braktisën shtabin qendror në gjimnazin e vendosur përballë rrugës së burgut tonë dhe dëgjua se e kishin braktisur tërë qytetin. Gjumnazi me parkun përreth dukej i shkretë e i frikshëm me hendeqe të zbrazura. Nga burgu i Zotoviqit, i cili ishte pranë tonit, nuk dëgjoheshin piskama. Me siguri, Zotoviqi* me xhelatët e tij festonin. Kishte vetëm një ndjekës të Nediçeviqit** që ecte përballë sallës së sokolave, me siguri rojtar. Në dhomë mbizotëronte një qetësi e çuditshme. Secili ishte i zënë në mendime për fatin e vet. Befas, nga larg u dëgjua zëri i avionit. E ndjemë se ato ishin bombarduesit. Sot, ardhja e tyre ishte më e zhurmshme. Ishte ora saktë dymbëdhjetë e një çerek pasdite. Përnjëherë u dëgjua zëri i frikshëm i bombarduesit në ulje. Ishte e qartë: do të na bombardojnë. Së pari dëgjova fishkëllimën shurdhuese, pastaj eksplozimin. Një, dy, dhjetë, njëqind ... Më dukej se bombat binin drejt mbi burg, mbi mua. Ndjekur nga frika e vdekjes, ika nga dhoma dhe u shtriva përdhe nën një dru në mes të oborrit. Derisa ushtonte e gjëmonte, mbi mua dhe rreth meje binin rrënoja dhe pluhur. Nga pluhuri i ngritur asgjë nuk shihej. Ndjeva goditje. Pastaj pash se s'ishte asgjë e rrezikshme. Këtu më goditi një copë tulle nga ndërtesat e rrënuara.

Anekënd rreth meje dëgjoheshin britma e rënime. Mirëpo, errësira nga pluhuri i ngritur ishte aq e thellë sa asgjë nuk shihja afër vetes. Gojën e kisha të mbushur me pluhur e dhe. Më në fund u ndalën rrënimet rreth nesh. Eksplozimet ishin më të rralla dhe më larg nesh, derisa më në fund çdo gjë u qetësua. Dalëngadalë ulej pluhuri, derisa depërtonin rrezet e diellit. Në ajër ndihej një djegie thartire. Kur u ngrita nga toka dhe shikova rreth vetes, për pak sa nuk u alivanosa. Të burgosurit iknin përtej telave. Dyert, dritaret, tjegullat e çatisë së burgut, çdo gjë u zhduk përnjëherë. Mbetën vetëm muret dhe dhomat, në një zbrazëti të pajetë. Nuk pash askënd të ishte vrarë. Domethënë, të gjithë i mbijetuan bombardimet. Burgu i Zotoviqit ishte rrënuar, gjithashtu dhe një pjesë e komunës ku ishte e vendosur policia. Pjesa e përparme e sallës së sokolave gjithashtu ishte zhdukur. Në vendin e hyrjes së mëparshme dukej një birë e madhe. Disa ndjekës të mbijetuar të Nediçeviqit, duke ikur shanin dhe i hidhnin armët. Shikova nga lindja. Gjumnazi më nuk ishte. Ishte rrafshuar me tokën.

*(*Mihajlo Zotović, major, komandant i “regjimentit të hekurt” të trupës së vullnetarëve serbë – organizatë kuislingësh nën komandën e Dimitrije Ljotiqit)*

*(**Nediçeviq – përkrahës i Qeverisë së Shpëtimit Kombëtar të Millan Nediqit, bashkëpunëtor i gjermanëve).*



Burimi 3

Fotografi të bombardimeve dhe dëshmi, Podgoricë, Mali i Zi

Dëshmi nga Podgorica 1

Grupi i parë prej 60 avionëve fluturoi mbi qytet dhe nga bishti lëshuan tym të bardhë, që deri atëherë nuk e kishim parë. Bënë një rrotullim mbi qytet duke e mbuluar me tym, sikur me këtë të kishin dashur të përkufizojnë hapësirën për të bombarduar, që u vërtetua pasi këtë edhe e bënë. Kur grupi i parë e përmbylli rrethimin, ndodhi ferri në tokë. Pasi grupi i parë i avionëve shkarkoi barrën e tij vdekjeprurëse, erdhi i dyti, pastaj edhe i treti. Nga forca e goditjes, toka u drodh, qyteti u rrënuar, pjesë nga trupat e njerëzve fluturonin në ajër. E humba nënën Milica (39) dhe motrën Zorka (8). U dëmtua edhe shtëpia jonë, e cila gjendej në qendër të qytetit, në anën tjetër të rrugës të shitorja "Beko". Edhe shumë shtëpi dhe ndërtesa u rrënuan dhe shumë familje u mbytën. Numri i të plagosurve dhe të vrarëve, asnjëherë nuk u vërtetua. Ndodhitë ndryshonin si në shirit filmi. Duhej të varrosnin të vdekurit dhe të vazhdohej me jetën në rrethana të okupimit ekzistues, tani më, në qytetin e shkatërruar. Jam i bindur që nuk ka pasur familje në qendër të qytetit, e cila nuk ka pasur ndonjë anëtar të vrarë apo të plagosur.



Nga ky bombardim më shumë është dëmtuar qendra e qytezës: rruga Balshicë, Novak Milloshev, bregu i Nemanjinës... Pas bombardimit ndodhi rrënujë e tmerrshme. Të mbijetuarit shpejtonin që sa më parë të braktisnin qytetin. Nën gërmadhat dëgjoheshin piskamat. Rrugët ishin të zëna dhe të shkatërruara, me gropa të mëdha dhe të thella. Pjesë të trupave të njerëzve qëndronin të varura nëpër tela të telegrafit, disa objekte digjeshin. Tymi t'i digjte sytë. Re tymi. Me një fjalë – ferr.

Dëshmi nga Podgorica 2

Bombardimet e natës më gjetën në qytet, në shtëpinë ku banonim. Pronarja e shtëpisë, kushërirë e jona, ishte grua që jetonte vet, kështu që çdo ditë e vizitoja dhe i sillja ushqim, aq sa kishim. Mbeta atë natë që të fle në shtëpi. Përnjëherë, u dëgjua ushtima e avionëve, eksplodim i fuqishëm i cili ndriçoi qytetin. Ndriçimi qëndroi për një kohë dhe ishte aq i fuqishëm sa të gjeje edhe gjilpërën. Dukej si vegim mbi qytetin e rrënuar. Nata u shndërrua në ditë. Pasi avionët aleatë shkarkuan barrën e tyre vdekjeprurëse, zotëroi heshtja. Flitej se atë natë kishte mjaft të vrarë, qytetarë që në atë kohë po ktheheshin nëpër shtëpitë e veta. Të nesërmen herët u zgjova dhe shkova te familja ime në Zagoriç. Duke kaluar pranë banesës ushtarake në një hapësirë të rrethuar pash disa parashuta. Kur u largova, vëreja se në to gjendeshin, të groposura në tokë disa vegla të metalta. Kur u tregova të mive për atë që kam parë, komshinjtë më të vjetër më thanë se ato ishin parashuta raketash, të cilat ndriçuan qytetin.



Më vonë shumë herë kam menduar pse qyteti jonë aq egërsisht u bombardua. Sipas asaj që ndodhi në Podgoricë, krijohet përshtypja se objektet strategjike as që kanë qenë qëllimi i tyre. Si ndryshe të shpjegohet fakti që asnjë urë, përveç asaj të Princshës nuk është rrënuar, ashtu si edhe asnjë objekt ushtarak.

Prof. Dr Branislav Kovačević, Savezničko bombardovanje Crne Gore, Podgorica 2003.

Burimi 4

Fotografi nga bombardimet dhe dëshmi nga Beogradi, Serbi

Dëshmia nga Beogradi

Rezultatet nga bombardimet e Beogradit të kryera nga aleatët perëndimor më 16 e 17 prill (1944) janë të atilla që tregojnë për viktima të shumta në Beograd. Nga objektet ushtarake u qëllua vetëm stacioni hekurudhor me vendet përreth, fabrika e pajisjeve ushtarake dhe shtëpia ku ishte vendosur Gestapoja në Dorqoll. Bombat u hodhën në të gjitha skajet e qytetit, u qëllua edhe spitali e sanatoriumi. Gjithashtu u qëllua spitali ushtarak, ku gjendeshin për t'u shëruar robërit, të riatdhësuarit. Më tej u rrënuan edhe institucionet tjera: klinika për sëmundje të brendshme, klinika e fëmijëve, spitali shtetëror, materniteti komunal, enti për fëmijët refugjatë dhe shumë banesa private.

Vendet tjera që u dëmtuan në Beograd janë edhe: rrethina në afërsi të Fakultetit Teknik, shtëpia e studentëve dhe sheshi Sllavia. Pastaj edhe rruga Terazie, rruga e Nemanjës, rruga e Milloshit të Madh, e Mbretreshës Natalija dhe rruga Sarajevës. Po ashtu u dëmtuan afërsia e Teatrit, Zeleni Venac dhe Tregu i Ri. Nëpër rrugë ishin trupat e pajetë të viktimave. Ata që mbijetuan, kishin ikur në anë të ndryshme. Rrugë të tëra ishin në flakë. Ndihma e parë nuk funksiononte. Edhe më tej kufomat gjendeshin në rrugë. Pasojat e këtij bombardimi ishin larg më të mëdha se ata të 6 prillit 1941. Beogradi që e dha 27 marsin nuk e meritoi këtë.

Gjenerali D. Mihailloviç, 21.4.1944.

Prof. dr Branislav Kovačević, Savezničko bombardovanje Crne Gore 1943-1944, GRAĐA, Podgorica 2003.



Bombing of Belgrade; *Military Encyclopedia of Yugoslavia*; 1958 edition

Fotografi dhe tekst nga bombardimi i Zarës, Kroaci



Sulmi i parë më intensiv i forcave aleate mbi Zarën u krye në mbrëmjen e 2 nëntorit 1943, kur mes objekteve tjera u rrënua jetimorja, që u ndoq edhe nga sulme të mëdha më 28 nëntor (mbi 200 viktima), më 16 dhe 30 nëntor të të njëjtit vit. Sulmet e para u shënuan nga një numër i madh i viktimave civile, ndërsa qyteti, edhe pse i dëmtuar, ende funksiononte. Sidomos bombardimi i rëndë ishte ai i 16 dhjetorit, kur u sulmuan strehimorja në Cereri (Voshtanica e sotme) dhe qendra e qytetit. Gjatë kësaj u vranë rreth 150-200 vetë. Në sulm morën pjesë 50 bombardues amerikan "Miçell" (B-25), të cilët hodhën 90 tonë bomba.

Sulmet, të cilat krejtësisht e rrënuan Zarën pasuan nga janari deri në mars të vitit 1944. Mirëpo, në këto sulme numri i viktimave ishte më i vogël, pasi që popullata që mbeti pa shtëpi dhe pa mjete ekzistence, iku nëpër vende periferike më pak të dëmtuara, si dhe nëpër ishujt e Zarës. Në pranverën e vitit 1944, në Zarë, së bashku me rrethinë, vlerësohet se ka pasur më pak se 4000 civilë. Edhe pse u nxorën jashtë funksionit të gjitha repartet industriale dhe limanet, gjermanët u detyruan të vendosnin limane ndihmëse, bombardimet vazhduan edhe gjatë tërë vitit 1944.

Nga periudha e verës qendra e Zarës praktikisht nuk ekzistonte më: numri më i madh i shtëpive tërësisht u shkatërruan, ndërsa mbeturinat e tyre i mbushën rrugët. Nga qershori deri në tetor nuk u vërejtën sulme më të mëdha, por sulmet e reja filluan nga mesi i tetorit të vitit 1944, kur u tërhoq ushtria gjermane. Bombardimet më të fuqishme ishin më 25 e 30 tetor. Bombardimi i fundit i aleatëve u krye më 31 tetor 1944, ditën kur hynë partizanët në Zarë. Zara përfundimisht u çlirua më 1 nëntor 1944. Supozohet se bombardimi i fundit ka ndodhur gabimisht, për arsye të komunikimit të keq. Gjatë kësaj u vranë disa partizanë.

Përveç shkatërrimeve, për të cilat përgjegjësi bartin bombarduesit aleatë dhe gjermanët që gjatë tërheqjes minuan Nova Rivën, ka mbet jo i sigurt numri i përgjithshëm i të vrarëve gjatë bombardimeve. Të dhënat e sakta, asnjëherë nuk do të jenë të vërtetuara, sepse në Zarën luftarake kishte lëvizje të mëdha të popullatës- popullsia lokale shkonte, vinin italianët nga qytetet tjera dalmatinase, po ashtu mbetet i pavërtetuar edhe numri pjesëtarëve ushtarakë. Numri më real është rreth 1.000 të vrarë, sepse shumica e popullatës ikën që nga sulmet e para në vjeshtë e në dimër më

Burimi 6

Trashëgimia dhe pamja bashkëkohore (dy përmendore në Podgoricë)



<http://portalanalitika.me/drustvo/tema/69476-bijela-ptica-i-crna-bomba.html>
(25.05.2013)

Dy përmendore në kryeqytetin e Malit të Zi, Podgoricë. Në anën e majtë është vendosur përmendorja me emrin Bomba e Zezë, e cila u ngrit për nder të 2000 qytetarëve të Podgoricës të vrarë në bombardimet e aleatëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Përmendorja u ngrit në vitin 1993.

Në anën e djathtë është vendosur përmendorja e quajtur Zogu i Bardhë, e cila u ngrit për nder të dy pilotëve aleatë. Dy pilotët u rrëzuan në qiellin e Malit të Zi nga kundërajrorët gjermanë në aksionin mbrojtës nga bombardimet e aleatëve mbi qytetet jugosllave gjatë Luftës së Dytë Botërore. Përmendorja u ngrit më vitin 2012.



Pyetje:

1. Pse u ngritën këto monumente?
2. Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet mes këtyre dy monumenteve?